

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 22/07/2026
PRIMLJENO:
Nr.Ne.Bn: 02/211



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë:13.07.2026

Procesverbal
i mbledhjes së -III (tretë) urgjente e Komitetit për Politikë dhe Financa

Koha:13.07.2026 ora 10:30

Vendi:Salla e mbajtjes së takimeve të Komisioneve të Kuvendit Komunal të Malishevës

Të pranishëm:Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj

Anëtarët e Komisionit për Politikë dhe Financa:Edonë Hoti,Gentiana Mehemti,

Imran Xhyliqi,Xheneta Morina,Veton Zogaj.

Zyrtar ligjor z.Muharrem Morina.

Përfaqësues nga zyra e informimit z.Artan Paçarizi.

Mbledhjen e udhëheqi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj meqenëse konstatoi se korumi ishte i mjaftueshëm për mbajtjen e seancës e hedhi në votim rendin e ditës si në vijimë:

Rendi i ditës

1. Kërkesë nga DKA-ja për mbështetje institucionale dhe buxhetore për funksionalizimin e tri çerdheve të reja publike.
- 2.Kërkesa e OVL-së, organizata e UÇK-së dega në Malishevë.
- 3.Kërkesa për mbështetje financiare për projektin "LIRIA KA EMËR".
- 4.Propozim profesional "Rrjedha e Lumit Mirushë".
- 5.Kërkesa për ngritjen e tarifës në "Ekoregjon" dega Malishevë.
- 6.Shqyrtimi i kërkesave nga zyra e kryetarit.
- 7.Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve.

Rendi i ditës u miratua unanimishtë nga të gjithë anëtarët e KPF-së.

Rezultati i votimit:6 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Kërkesë nga DKA-ja për mbështetje institucionale dhe buxhetore për funksionalizimin e tri çerdheve të reja publike.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kërkesën dhe materialin e keni pranuarë me kohë e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Venton Zogaj(anëtarë i KPF-së):Faleminderit Kryesues.Përsëritje për të gjithë ju kolegë,këtë kërkesë e kemi trajtuar në seancën e kaluarë në Kuvend me të cilën ka pasur shumë debate,sot shumë mirë që e kemi sjellur në KPF dhe jemi duke e trajtuar realishtë këtu bëhet fjalë për tri çerdhet mirëpo meqenëse drejtoresha e arsimit nuk është prezentë nuk e di se qfarë me diskutuar.A duhet ne ta rekomandojmë këtë kërkesë në Kuvend dhe pastaj ta miratojmë në Kuvend dhe të presim më tutje hapat e tjerë nga Ministrinë përkatëse?

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kërkesën e DKA-së e kemi diskutuarë në Kuvend dhe pak a shumë është shtjerrur debati,e hedhi në votim.Kush është për?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0abstenim.

Miratohet unanimitë propozim kërkesa e DKA-së dhe i procedohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Kërkesa e OVL-së, organizata e UÇK-së dega në Malishevë.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kjo kërkesë është paraqitur nga Organizatat e daluara nga lufta dega në Malishevë,ata kanë kërkuarë me marrë në shfrytëzim një veturë për nevojat e organizatës së OVL-së UÇK-së dhe me i mbështetur me mjete financiare për realizimin e aktiviteteve organizative.Unë rekomandojë që kjo kërkesë të shkonë në Asamble komunale dhe të trajtohet më gjerësishtë.E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Venton Zogaj(anëtarë i KPF-së):Unë e kam diskutuarë këtë kërkesë me Kryetarin e shoqatës së OVL-së,ai më ka treguarë që e ka paraqitur kërkesën dhe natyrishtë që ne e mbështesim plotësishtë,por tani që e kam para vetës këtë kërkesë e vërej që është e pa kompletuarë,në pikën e parë shkruanë që kanë kërkuarë në shfrytëzim të dhënies së një makine kurse në pikën e dytë ka kërkuarë mbulimin e shpenzimeve operative mirëpo nuk e kanë specifikuarë shumën se sa ju nevojitet.

Unë e kam parasyshë që shoqata e OVL-së kanë organizime të ndryshme siq janë vizitat për përvejtore,vizita në terren mirëpo është dashur për afërsishtë me cekur një shumë,mirëpo ne sigurishtë që në Asamble Komunale do të dakortohemi si grupe parlamentare me ju ndarë një shumë të caktuarë së bashku me Drejtorin për Ekonomi dhe Financa nëse aty vjen si numër në kërkesë.Faleminderit.

Imran Xhyliqi(anëtarë i KPF-së):Kryesues,kërkesa a është për dhënie në shfrytëzim të një makine apo për blerjen e një makine të re?

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kërkesa është për dhënie në shfrytëzim të një makine nga institucioni komunal,pastaj Kryetari i Komunës e mbanë qëndrimin e tij dhe kordinohen me Ekzekutivin për këtë qështje.Ne si anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa është mirë me rekomanduarë në Asamble komunale këtë kërkesë,unë e hedhi në votim.Kush është për?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenim.

Miratohet unanimitë propozim kërkesa e OVL-së, organizata e UÇK-së dega në Malishevë si dhe i procedohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës: Kërkesa për mbështetje financiare për projektin "LIRIA KA EMËR".

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kjo kërkesë është propozuarë nga Kryetari i Komunës që të rekomandohet për trajtim në Asamble Komunale, shumica e komunave të Republikës së Kosovës kanë filluarë me mbështetur kërkesën e organizatës joqeveritare "LIRIA KA EMËR" edhe ne është mirë me rekomanduarë për Kuvend Komunal pastaj e vlerësojmë sa mjete financiare ka mundësi me ju ndarë.

Imran Xhyliqi(anëtarë i KPF-së):Ata e kanë specifikuarë shumën e vlerës prej 5,000 €

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Unë e kam vërejtur që shumica e komunave e kanë kaluarë këtë kërkesë për Asamble Komunale,mirëpo sa është ligjore me inplementuarë këtë kërkesë e presim më tutje.

Veton Zogaj(anëtarë i KPF-së):Në këtë dilemë ka mundësi me na ndihmuarë shumë z.Muharremi sepse ky projekt është regjistruarë si platëfomrë e organizatës joqeveritare.Sa kemi të drejtë ne si institucion i komunës me mbështetur kërkesën e ojq-së e cila nuk operonë në komunën tonë?Unë jam në parim për me mbështetur kërkesën.Sa kemi të drejtë me ju ndarë mjete ojq-së-pa aplikuarë në subvencionim?Unë e di që komuna e ka një Rregullorë dhe zakonishtë ojq-të aplikojnë kur ka thirrje publike për projekte të caktuara dhe pastaj komisioni përkatës e ndanë shumën e caktuarë.Sa është ligjore një kërkesë e tillë?

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Këtë kërkesë do ta trajtojmë në Kuvend,e hedhi në votim.Kush është për?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenim.

Miratohet unanimishtë propozim kërkesa për mbështetje financiare për projektin "LIRIA KA EMËR" si dhe i procedohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Pika e katër e rendit të ditës: Propozim profesional "Rrjedha e Lumit Mirushë".

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Për këtë pikë materialin e keni pranuarë në email adresë në këtë takim ka pasur me ardhë një zyrtar i komunës tonë mirëpo nuk ka ardhur,mirëpo në seancën e Kuvendit që do të mbahet kanë premtuarë që do të vijnë zyrtarë nga Ministria por kanë kërkuarë ti njoftojmë më heret,por ne sigurishtë që do ti njoftojmë një javë për para sepse njoftimi për seancën e Kuvendit është publik edhe në faqen zyrtare të komunës.Kush është për?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenim.

Miratohet unanimishtë kërkesa Propozim profesional "Rrjedha e Lumit Mirushë" si dhe i procedohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Pika e pestë e rendit të ditës:Kërkesa për ngritjen e tarifës në "Ekoregjon" dega në Malishevë.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Para se me filluarë me debatin,mendoj që është mirë me u ndryshuarë Rregullorja pastaj me ardhur kjo pikë në KPF dhe në Asamble Komunale.Unë sot e kam pasur një takim me anëtarët e Ekoregjonit dhe ata më rekomanduanë që të shtyhet kjo pikë dhe të diskutohet edhe njëherë me Kryetarin.A ka dikush debat për këtë pikë të rendit të

ditës?Atëherë nëse nuk ka dikush me marrë fjalën.Kush është për që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenim.

Pika e 6

Pika e gjashtë e rendit të ditës:Shqyrtimi i kërkesave nga zyra e kryetarit.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kërkesat që kanë ardhur nga zyra e Kryetarit disa ju kemi dërguarë në emailin tuaj elektronik kurse të tjerat do të na lexojë z.Muharrem Morina.

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina:Përshëndetje për të gjithë!Unë do ti lexojë disa kërkesa që janë pregaditur nga zyra e Kryetarit të Komunës Ju e dini që më parë Komuna e ka marrë një vendim për dhënie në shfrytëzim afat shkurtë të një parcele në fshatin Banjë,vendimi është marrë në vitin 2026-të,mirëpo MAPLja ka thënë që këtë parcelë fillimishtë duhet me ndarë me vendim pastaj me dhënë në shfrytëzim,në vitin 2026-të është marrë vendimi janë ndarë parcelate,prej një parcele realishtë tani janë tri parcella me numër të ri,ne vendimin e kemi dërguarë në MAPL dhe ata e kanë dërguarë në Ministrinë e Ambientit për shkak që Agjensioni Kadastral dhe Ministria e Planifikimit është ajo që e monitoronë.

Në afatin ligjor ata nuk e kanë kthyer një shkresë se qfarë mendojnë lidhur me këtë qështje,madje ende nuk kemi përgjigjje.Vendimi i Asamblesë pasi që kalonë afatin prej 30 ditë që nga momentin i nxjerrjes do me thënë edhe 7 ditë që duhet me u bërë publikimi i saj bëhet i plotëfuqishëm meqenëse këto procedura kanë kaluarë,vendimi i Asamblesë është bërë i plotëfuqishëm dhe unë e kam dërguarë lëndën në Agjensionin Kadastral për me ndarë pronën me i bërë tri parcella prej një parcele ashtu siq ka kërkuarë MAPL-ja të jetë njejtë me vendimin e Asamblesë komunale.Tani i kemi dy parcella njëra është për dhënie në shfrytëzim e para është e caktuar me vendim të Asamblesë për dhënie në shfrytëzim të deponimit të mbeturinave ndërsa edhe katër të tjerë mendohet me u dhënë në shfrytëzim për afat të shkurtër deri në 15(pesëmbëdhjetë) vite.Afati i shkurtër nën kuptonë më tepër se një vitë dhe më pak se 15(pesëmbëdhjetë) vite.

Ajo qfarë mbetet është nëse Kuvendi i Komunës e lejonë hapjen e procedurës për dhënie në shfrytëzim afat të shkurtër atëherë ka me u caktuarë edhe shumën e qirasë për hektarë dhe ka me caktuarë sa vite e lejonë procedurën e ankandit.
Kërkesa besojë që ka me u skanuarë dhe keni me pranuarë secili prej juve në email adresën tuaj pra do ta keni të kompeltuarë.

Tek kjo kërkesë sipas dipozitave ligjore kërkohet me u formuarë një komisionë me të cilën ka me u marrë me procedurat e ankandit publik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
Ky komision përbëhet prej pesë anëtarëve dy i caktonë Kuvendi,dy Kryetari dhe një duhet të jetë nga shoqëria civile.
Këtë procedurë ne e kemi sjellur njëherë në Kuvend e kemi votuarë,janë ndarë parcelate,janë ekzekutuarë vendimet në kadastër,tani i kemi dy parcella të reja gjithashtu edhe parcella e vjetër që nënkuptonë tri parcella.

Këtu janë të përshkruara parcelate,këtu është përshkruarë edhe komisioni i cili kërkohet me u formuarë për me i zhvilluarë procedurat e ankandit.Për dy kërkesa duhet dy vendime të

veqanta.Nëse ju mendoni me shku mëtutje kjo është kërkesa e Kryetarit të Komunës për me zbatuarë vendimin e Asamblesë konkretisht në bazë të udhëzimit që e ka kërkuarë MAPL-ja.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kush është për që kjo kërkesë e Kryetarit të rekomandohet për Kuvend Komunal?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenim.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Vazhdojna me kërkesat e tjera që i ka paraqitur Kryetari.Fjalën ja kalojë z.Muharrem Morinës.

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina:E njehta procedurë që është me formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim,ju e dini që në muajin Mars e ka miraturë vendimin për listen e pronave për dhënie në shfrytëzim afat gjatë e cila është rikthyer për plotësim,ndryshim dhe harmonizim. Unë e kam marrë lëndën e kam harmonizuarë në bazë të kërkesës që e kërkonë Ligji dhe Rregullorja për dhënien në shfrytëzim dhe në bazë të udhëzimeve që i kemi marrë nga MAPL-ja është bërë konfirmimi i ligjshmërisë për dhënie në shfrytëzim do me thënë për listën e pronave për afat të gjatë.Kryetari i Komunës në rastin konkret me këtë kërkesë kërkonë që në pajtim me vendimin e Kuvendit dhe listën e pronave për hapjen e konkursit për hapjen e dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës publike,kërkonë që të lejohet hapja e procedurës për tri parcella,një parcellë është në fshatin Mirushë,një në fshatin Llozicë dhe një në fshatin Carrallukë.

Për këto parcella ka të interesuarë me investuarë,në fshatin Carrallukë është një marveshje Koreanë-Gjerman-Zvicërran për me ndërtuarë një fabrikë për panela solare,ata kanë shfaqur interesin dhe e kanë sjellur kërkesën mirëpo pa i përfunduarë ne me futureë në listën e pronave për vitin 2026-të dhe pa e shtyrë kërkesën e Kryetarit në Kuvend nuk lejohet me hapur thirrjen e interesit.

Nëse ju e lejoni dhe e konfirmoni kërkesën e Kryetarit me vendim dhe konfirmohet nga MAPL-ja ka me u bërë thirrje publike dhe ne pastaj presim që ata njerëz që janë të interesuarë prej vitit të kaluarë që me marrë atë parcellë dhe me zhvilluarë një aktivitet bizensorë i cili është shumë i rëndësishëm dhe atraktiv për Komunën e Malishevës për prodhimin e panelave solare,një shoqëri aksionare Korean,Zvicërran dhe Gjerman janë në bashkë bisedim me një qytetarë nga fshati Banjë kurse tjetri nga fshati Vermicë këta dy jetojnë në Zvicërr dhe ata merren me shitjen dhe montimin e panelave solare.

Nëse hapet konkursi dhe aplikojnë pastaj duhet me u marrë vendim pastaj me pasur debate me qytetarët me i informuarë për projektin.Një fabrikë tjetër që pritët me u ndërtu unë ju kam treguarë që nëse ndërtohet duhet me pasur raportin e vlerësimit sepse ajo fabrik ka zhurmë dhe ju e dini që për shkak të ambientit qytetarët nuk e lejojnë mirëpo janë disa procedura që kanë me u kryerë më vonë së bashku me Ministrinë e Mjedisit.

Kërkesa e Kryetarit është për këto tri parcella në këtë faze,parcellate janë të përshkruara në listen e pronave të veqanata për vitin 2026-të të cilën ju i keni votuarë për me i dhënë në shfrytëzim për këtë duhet edhe me u themluarë komisioni besojë që ju tani më e keni përvojën i cili ka me i zhvilluarë vetëm procedurat dhe nuk kanë kompetenca të tjera dhe pastaj Asambleja ka me vlersuarë a me lejuarë apo jo,në të kaluarën ka qenë e njehta procedurën në afat shkurtër kurse tani është në afat gjatë,janë tri parcella në fshatin Llozicë,Carrallukë dhe Mirushë.

Kopjet e planit dhe të qertifikatës i keni brenda në lëndë dhe në momentin që ju shpërndajnë materialin do ti gjeni aty.

Imran Xhyliqi(anëtarë i KPF-së):Kryesues nëse specifikishtë ipet parcella në fshatin Carrallukë në shfrytëzim për këto biznese që me ndërtuar panella solare,nëse nuk e marrin këta këtë parcellë. A mundet me u dhënë në shfrytëzim për ndonjë qytetarë tjetër që shprehë interesim,nëse ju dështonë përshembullë atyre projekti?

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Jo nuk mundet.

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina:Ata janë mërgimëtarë kanë qenë tek ne dhe unë kam qenë shumë i kuartë ndaj tyre,ne kemi me dërguarë në listën e veqantë pastaj kemi me pritur me aprovuarë MAPL-ja ,ne kemi me dërguarë kërkesën e Kryetarit në Kuvend ashtu siq e aprovonë Kuvendin dhe Ministria,pastaj ka me u bërë thirrja publike por ajo nuk garantonë që ne kemi me ja u jepur atyre sepse ka mundësi me aplikuarë dikush tjetër që është më i favorshëm se ajo oferta tjetër.Në momentin që hapet shpallja pranohen të gjitha kërkesat që kanë aplikuarë dhe pastaj shqyrtohen.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kush është për që të rekomandohet për Asamble Komunale?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenim.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:A kemi ende kërkesa të tjera z.Muharrem?

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina:Po kemi ende kërkesa,ne biseduamë më parë me z.Veton Zogaj për kërkesën e z.Bekim Gashit Kryeshefin Ekzekutiv të KRU-së të Hidroregjionit Jugor kërkesë për shpronësim të pronës private për rritjen e kapaciteteve akumuluese të ujit-Rezervuari i ri Banjë.

Përmes kësaj shkrese zyrtare, Kompania Rajonale e Ujësjellsit "Hidroregjioni Jugor" SH.A dëshironë të paraqesë para jush kërkesën për bashkëpunim dhe ndërhyrje institucionale me qëllim zgjidhjen pronësore të projektin e rritjes së kapaciteteve të ujit të pijshëm për qytetarët e komunës së Malishevës.

Siç jeni në dijeni KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A aktualishtë posedon dhe menaxhon rezervuarin ekzistues të ujit, i cili ndodhet në parcelën kadastrale nr. 2870-2 Zk Banjë,pronë kjo nën menaxhimin dhe pronësinë e Kuvendit Komunal të Malishevës.

Në kuadër të planeve tona për zhvillim dhe pas realizimit të studimit të fizibilitetit për rritjen e kapaciteteve furnizuese,ka rezultuarë se është teknikishtë e domosdoshme zgjerimi i rezervuarit aktual.Mirëpo sipas projektit të detajuar shtrirja fizike e këtij zgjerimi e prek edhe parcelën fqinje nr.2870/1 i pronë private.

Për këtë arsyeje kërkonë nga Komuna e Malishevës që të inicojë procedurat e shpronësimit për interes publik të parcelës nr.2870-1 Zk Banjë me sipërfaqe 800 m² nga sipërfaqja totale e parcelës 3141 m²,në mënyrë që të mundësohet realizimi i këtij projekti vital për komunitetin.

Opsioni Alternativ: Në rast se procedurat e shpronësimit në parcelën e lartpërmendur,hasin në vështirësi ligjore apo administrative,projektuesit tanë kanë identifikuarë si lokacion të mundshëm edhe parcelën përballë me nr.2842-0 Zk Banjë.

Dëshirojmë të theksojmë që këto dy propozime (zgjerimi në parcelën 2870-1 ose ndrimi i ri në parcelën 2842-0)janë të vetmet zgjidhje të zbatueshme nga ana inxhinierike.

Këto propozime kushtëzohen nga lartësia mbidetare,pasi ulja e kuotës aktuale do të rrezikonte funksionimin e rregullt të sistemit të furnizimit me ujë dhe shtypjen e nevojshme në rrjet.

Pra në momentin që kjo 2870-1 që e kanë kërkuarë është tek bazeni ekzistues, te kjo pjesa tjetër kërkojnë edhe 8 ari të tjera me ja bashkangjitur që me ja shtuarë kapacitetin Ujësjellësit.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:A është prona komunale?

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina:Jo nuk është pronë komunale ne biseduam edhe me z.Vetonin, prona është private, kjo është në Osman Limaj Haxhi, ne kemi biseduarë edhe me Kryetarin e Komunës. Ne hapin e parë duhet me bërë me shpallë zonë me interes të përgjithshëm publik këtë sipërfaqe prej 8 ari, pastaj palën e thirrë Drejtoria e Gjeodezisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike. Pastaj ne i kemi dy procedura nëse pala mendonë që me i vlerësuarë këto 8 ari në vlerën financiare, Kryetari e nxjerrë vendimin për shpronësim dhe pastaj e bënë vlerësimin Ministria e Financave, nëse pala deklaronë që nuk dëshironë të holla por pronë publike, pastaj ne me palën duhet me u dakortuarë se ku ka pronë publike në zonën kadastrale në Banjë me i ofruarë atij në bazë të vlerësimit të Ministrisë së Financave dhe Dapartamentit të vlerësimit të pronave të paluajtshme dhe me i këmbyer.

Do me thënë janë dy procedura mirëpo ne pa pasur marrëveshje me palën nuk kemi mundësi me vazhduarë më tutje sepse pala e ka të drejtën që quhet zotësi juridike e pronës dhe ka mundësi me na bllokuarë projektin përmes Gjykatës.

Pa marrëveshje nuk kemi mundësi me realizuarë kurse me marrëveshje janë dy procedura në shpronësim dhe këmbim.

Ne e bëjmë fazën e parë e shpallim zonë me interes publik, e thirrjmë palën nëse pala pajtohet ne i kemi dy procedura me të holla ose me pronë, me cilën pajtohet pala ne e zhvillojmë procedurën më tutje.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Atëherë ne po e rekomandojmë këtë pikë për trajtim në Kuvend. Kush është për?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenime.

Miratohet propozim kërkesa e e parashtruar nga ,KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A kërkesë për shpronësim të pronës private për rritjen e kapaciteteve akumuluese të ujit- Rezervuari i ri Banjë si dhe i procedohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:A ka kërkesa të tjera z.Muharrem?

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina:Kemi një kërkesë që është paraqitur nga Kryetari i fshatit Bubavec ai ka shkruarë: I lutem Kryetarit të Komunës që të na bëjë të mundur që në parcelën me numër P-72310003-00833-2 pronë e komunës së Malishevës të fillojë me ndërtimin e një fushe dhe rekreacioni dhe kjo pronë të shpronësohet dhe nga prona komunale të të jepet në shfrytëzim për ndërtimin e një stadiumi në bashkëpunim me Federatën e Futbollit, fushë e cila do të shërbente jo vetëm për fshatin Bubavec por edhe si fushe ndihmëse për FC Malishevën. Ju lutem që të vendosni pozitivisht e kemi bashkangjitur edhe fletën poseduese.

Realishtë unë e kisha të pa kjashtë, pala që e ka paraqitur kërkesën ka biseduarë me Kryetarin ai ka deklaruarë se ka marrëveshje me Federatën dhe ju ka kërkuarë që ata me ndarë pronën dhe pastaj ata i financojnë në ndërtimin e këtij stadiumi dhe ky me qenë si stadium ndihmës për stadiumin kryesor.

Unë kam biseduarë me Kryetarin që fillimishtë këtë kërkesë me paraqitur në Kuvend për trajtim pastaj me pyetur edhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal se a na lejohet neve me caktuarë një lokalcion në këtë parcelë pa hyrë në procedurë të shpronësimit. Nëse MAPL-ja thotë caktone lokalcionin pastaj hyni në marrëveshje me Federatën për me bërë invensitmin në mënyrë që mos me na ikur investimi nëse është serioz, mirëpo edhe ne mos të dalim qesharak që me shpronësuarë pronën publike.

Nëse ju pajtoheni e sjellim në Kuvend, para se ne me nxjrrur vendimin konsultohemi me MAP-në, ligji na mundësonë një konsultim para praktikë. A na lejohet me caktuarë një zonë të tillë për ndërtimin e një stadiumi për shkak që është diskutabile sepse në atë zone atje nuk e dim a është tokë bujqësore apo qfare është parashikuarë në plan zhvillimorë.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj: Mandati i Kryetarëve të Këshillit të Bashkësive Lokale ka përfunduarë. Ne fillimishtë këtë kërkesë po e dërgojmë për Asamble komunale pastaj e trajtojmë më tutje, interpretimin që e tha z.Muharremi është rruga e vetme që kemi mundësi me trajtuarë ose ne kemi mundësi me refuzuarë menjëherë tani.

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina: Ne do ta pyesim MAPL-në, se a na lejohet me dhënë këtë lokacion për këtë stadium.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj: Kush është për që kjo kërkesë të trajtohet në Asamble?
Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Miratohet propozim kërkesa parashtruarë nga Kryetari i Bashkësisë Lokale në lidhje me kërkesën e parcellës me numër P-72310003-08833-2 pronë e Komunës në Malishevë të fillojë me ndërtimin e një fushe futbolli dhe rekreacioni si dhe i procedohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj: Kërkesa të tjera a ka z.Muharrem?

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina: Po, e kemi edhe një kërkesë për biznes që e ka paraqitur z.Afrim Gigollaj kërkesë për vazhdimin e shfrytëzimit të pronës komunale për 30 vite.

Ky është një biznes privat Furra e bukës "Pashtriku" në Banjë që në vitet e 90-ta ju është ndarë një parcelë prej institucionave të më herëshme, tani ka paraqitur kërkesë që me vazhduarë edhe për 30 vite të tjera, unë i tregova edhe Nënkryetarit që aty për me vazhduarë është një procedurë tjetër, ndërsa për me dhënë në shfrytëzim është diqka tjetër. Pala e ka në shfrytëzim por kërkonë me vazhduarë edhe më tutje për 30 vite, mirëpo pala nuk e ka të kompeltuarë lëndën duhet me kompletuarë.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj: Kush është për që kjo kërkesë të trajtohet në Kuvend?
Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Miratohet propozim kërkesa e parashtruarë nga z.Afrim Gigollaj për vazhdimin e shfrytëzimit të pronës komunale për 30 vite si dhe i procedohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj: Kërkesa të tjera a keni z.Muharrem?

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina: Po e kemi një kërkesë që ka kërkuarë për këmbim kjo është një procedure tjetër realishtë: Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës, organet

kompetente të komunës së Malishevës në vitet e 19-ta kanë nxjerrur vendim me të cilën znj.Melihate Telakun nga Banja i kanë ndarë prona për privatcion të përkohshëm për objektin montazh për të kryerë veprimtari zejtare në sipërfaqe prej 35 m²,pas supermimit të Statutit të Komunës së Malishevës në vitet e 90-ta në të njejtën parcelë e njejtë ka ndërtuar edhe objektin e banimit me të cilën ka jetuar me familje por ka hyrë në depozitim në një sipërfaqe pak më të gjerë se sa në sipërfaqe prej 30 m² sepse ka qenë e pa mjaftueshme ndërtimi i shtëpisë për familje. Që nga ajo kohë e deri më sot unë kam shfrytëzuar atë parcelë dhe kam paguar të gjitha obligimet që janë kërkuar nga Komuna e Malishevës.Andaj i propozoj Kuvendit që në sipërfaqen e lartë cekur të cilën e shfrytëzojë që nga vitet e 90-ta të më këmbejë me pronë private e cila gjindet në njësinë kadastrale nr. 2721-6 zona kadastrale në Banjë në vendin e quajtur Gajrakë kullojë klasi i tretë në emër të Adiran Aziz Telaku.

Arsyeja e këmbimit është që në vitet e 90-ta kam ndërtuar shtëpinë në atë pjesë të njësië kadastrale,kurse këmbimi do të bëhet në bazë të vlerësimit të Drejtorisë përkatëse.

Pra në vitet e 90-ta i kanë dhënë pronë në sipërfaqe prej 30 m² e ka hapur lokal për biznes afaristë,tani po kërkonë që me marrë pronësinë me këmbim me i dhënë komunës atë pronë dhe me marrë dikunë tjetër.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Ne i kemi edhe dy kërkesa të tjera dhe e kam ndërmend me kërkuar nga Drejtoritë përkatëse që me i sjellur lëndët e kompletuara.

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina:Kemi edhe Raportin e Komisionit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës publike,anëtarët e komisionit janë:unë,z.Halil Morina,z.Fitim Shala,z.Rifat Mazreku dhe z.Veton Telaku kur e kemi pregaditur raportin për Kuvend ka munguar vetëm z.Halil Morina nënshkrimet janë të përcaktuara,vendimi i Asamblesë është i vitit 2024-të me të cilën i ka dhënë të drejtë komisionit që me bërë thirrjen publike për shpallje të interes publik përmes thirrjes publike aty bëhet fjalë për zonën kadastrale në Goriq në Bjeshkë.

Kryesuesi besojë që është në dijeni,komisioni e ka shpallur kemi një fermë e cila është e interesuarë me zhvilluarë veprimtari në atë zonë me hapur fermë për xhela,pula,për dele,dhi dhe bletë e ka kërkuarë një sipërfaqe prej 14 hektarë është në krye të Goriqit atje në Bjeshkë.Ai e ka paraqitur ofertën e vet të kompletuarë ashtu siq e kërkonë Rregullorja e Qeverisë për Dhëninën dhe Këmbimin e Pronës Publike,raporti është i përpiluarë nga Komisioni dhe është i protokoluarë me date:03.07.2026-të.

Kërkohet që nëse ju e merni vendimin dhe konfirmimin e Ministrisë,pala së bashku me Kryetarin e lidhin kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës publike në afat të gjatë. Kërkesa është përpiluarë për fermë ai është fermerë.

Veton Zogaj(anëtarë i KPF-së):Kush është ky nëse ka mundësi me ditur?

Zyrtar ligjor i K.K z.Muharrem Morina: Ai është Mazreku Farm ai merret me fermë ishte përfitues edhe i një donacioni të Ministrisë për me zgjeruarë dhe zhvilluarë aktivitetin e vetë,por tani nëse Komuna ja jep ato parcela që i ka kërkuarë,ky është i gatshëm për me zgjeruarë ku përveq lopëve dhe qumështoreve me bërë edhe për dhi e dhenë,pula do me thënë shpenztari edhe mjaltë.Ky është raporti i kompeltë lëndës.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Ky raport është mirë me u trajtuarë edhe në Asamble Komunale dhe me marrë mendimet edhe të grupeve të tjera parlamentare.Kush është për?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenime.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Ju faleminderit z.Muharrem për trajtimin e kërkesave

Pika 7

Pika e shtatë e rendit të ditës: Shyqyrtimi i kërkesave të qytetarëve.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Te kërkesat e qytetarëve unë i kam gjashtë kërkesa që ata kanë qenë vazhdimisht në zyren time.

Kërkesat e qytetarëve:

- 1.Sadbere Bellani
- 2.Hasime Bajra
- 3.Servete Shala
- 4.Saniye Kryeziu
- 5.Hysen Pintolli
- 6.Bukurie Krasniqi

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Kush është për që të ndahen mjete financiare në shumën e vlerës prej 400(katërqind)euro për emrat e lartë cekur?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,0 abstenime.

Miratohen unanimisht kërkesat e qytetarëve të lartë cekur për mbështetje në ndihmë momentale në shumën e vlerës prej 400(katërqind) euro.

Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Ju falenderojë të gjithë për anagazhimin tuaj në mbledhjen e KPF-së.Uroj që të jeni mirë në ditët e tjera në vazhdim,seancën e Kuvendit pritet të thirret ditën e Marte ose të Mërkurën në varësishtë prej rrethanave,ashtu siq u dakorduam besojë që para mbledhjes do ti mbajmë një mbledhje të KPF-së për shkak që i kemi dy kërkesa njëra raportin gjashtë mujor të Drejtorisë së Financave e cila nuk është e gatshme deri më datën 15 Korrik dhe kërkesa tjetër është nga Drejtoria për Shërbime Publike.Mbledhjet do të thirren paralelishtë në atë ditë vetëm ndryshonë orari njëra në ora 9 kurse tjetra në ora 10 nuk ka ndonjë pengesë juridike dhe ligjore.


Ju falenderojë edhe një here të gjithëve.

Kryesuesi i Komisionit për Politikë dhe Financa i përfundoi punimet e mbledhjes rreth orës

Malishevë

Procesëmbajtësja

Fatlume Delija



Kryesues i Komitetit të KPF-së

Fatmir Ademaj

